

210
Dt 13.01.2026



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI I ZHVILLIMIT URBAN

Nr. 22/ prot.

Elbasan, më 21.1.2026

Lënda: Konfirmim akti

KËSHILLIT BASHKIAK LIBRAZHD

Në zbatim të nenit 16 të Ligjit Nr.107/2016 dt.27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", i ndryshuar, pasi u verifikua ligjshmëria e aktit tuaj nr.116 dt.23.12.2025 "Për miratimin e rinovimit të kontratës së shërbimit publik për pranimin, depozitimin dhe trajtimin e mbetjeve të Bashkisë Librazhd, në impiantin e trajtimit të mbetjeve urbane të Qarkut Elbasan, midis Bashkisë Librazhd dhe Shoqërisë Eco-Elb Sh.A.", konfirmojmë në parim, mbështetjen e tij në ligj.

PREFEKTI

Ilir BEJTJA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LIBRAZHË
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Datë.29.12.2025

Nr. ___ prot

Nr.116 dt.23.12.2025

Për miratimin e rinovimit të kontratës së **“Shërbimit publik për pranimin, depozitimin dhe trajtimin e mbetjeve të bashkisë Librazhd”** në “Impjantin e trajtimit të mbetjeve urbane të Qarkut të Elbasanit midis Bashkisë Librazhd dhe Shoqërisë “ECO-ELB” sh.a.

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës 23.12.2025, pasi shqyrtoi relacionin dhe dokumentacionin e paraqitur nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit , bazuar në:

Ligjin 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore” nenet 8, 9, 54 të tij;

Ligjin Nr.10463 datë 22.9.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve" të ndryshuar;

Ligjin nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenet 9 e 11;

VENDOSI:

1. Të miratojë rinovimin e kontratës së **“Shërbimit publik për pranimin, depozitimin dhe trajtimin e mbetjeve të bashkisë Librazhd”** , në “Impjantin e trajtimit të mbetjeve urbane të Qarkut të Elbasanit midis Bashkisë Librazhd dhe Shoqërisë “ECO-ELB” sh.a.,sipas draftit bashkangjitur.
2. Ngarkohen Kryetari dhe Administrata e Bashkisë me zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETAR I KËSHILLIT
Elson MALLUTA

KRYETARI I KËSHILLIT
Mitat BIÇAKU



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LIBRAZHD
KRYETARI

PROJEKT-VENDIM

Nr _____ Datë ____/____/2025

Për miratimin e rinovimit të kontratës së *“Shërbimit publik për pranimin, depozitimin dhe trajtimin e mbetjeve të bashkisë Librazhd”* në “Impjantin e trajtimit të mbetjeve urbane të Qarkut të Elbasanit midis Bashkisë Librazhd dhe Shoqërisë “ECO-ELB” sh.a.

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës _____.2025, pasi shqyrtoi relacionin dhe dokumentacionin e paraqitur nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, bazuar në:

Ligjin 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore” nenet 8, 9, 54 të tij;

Ligjin Nr.10463 datë 22.9.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve" të ndryshuar;

Ligjin nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenet 9 e 11;

Vendosi

1. Të miratojë rinovimin e kontratës së *“Shërbimit publik për pranimin, depozitimin dhe trajtimin e mbetjeve të bashkisë Librazhd”*, në “Impjantin e trajtimit të mbetjeve urbane të Qarkut të Elbasanit midis Bashkisë Librazhd dhe Shoqërisë “ECO-ELB” sh.a., sipas draftit bashkangjitur.
2. Ngarkohen Kryetari dhe Administrata e Bashkisë me zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETARI BASHKISË
MARIGLEN DISHA

Relacion

Mbi miratimin e rinovimit te kontratës së **“Shërbimit publik për pranimin, depozitimin dhe trajtimin e mbetjeve të bashkisë Librazhd”** në “Impjantin e trajtimit të mbetjeve urbane të Qarkut të Elbasan midis Bashkisë Librazhd dhe Shoqërisë “ECO-ELB” sh.a.midis Bashkisë Librazhd dhe Shoqërisë “ECO-ELB” sh.a.

Këshillit Bashkiak

Ketu

Siç jeni në dijeni, shoqëria “ECO-ELB” sh.a. është krijuar si shoqëri publike me kapital të përbashkët të të gjithë bashkive të Qarkut Elbasan, dhe ka si objekt trajtimin dhe përpunimin e mbetjeve urbane në “Impjantin e trajtimit të mbetjeve urbane të Qarkut të Librazhdit”

Pas vendimin nr. 484, datë 13.12.2021 të Gjykatës së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, për vendosje të sekuestros konservative për shoqërinë “Albtek Energy” sh.p.k., ky impjant është vënë në administrim të Agjensisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara, deri në përfundimin e procesit dhe marrjen e një vendimi përfundimtar nga gjykata. Me kontratën e qirasë nr. 548, datë 21.02.2022, Agjensia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, i ka dhënë shoqërisë “ECO-ELB” sh.a., kundrejt qirasë prej 1 (një) Euro në muaj (bruto), Impjantin e trajtimit të mbetjeve urbane të Qarkut të Librazhdit” në tërësinë e tij, me qëllim vënien në funksion dhe përpunimin e mbetjeve urbane të të shtatë bashkive të Qarkut Elbasan.

Në këto kushte, bazuar në nenet 9 e 11 të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, secila nga bashkitë e Qarkut, përfshirë edhe Bashkinë Librazhd, do të lidhin me shoqërinë publike “ECO-ELB”sh.a., **kontratën e “Shërbimit publik për pranimin, depozitimin dhe trajtimin e mbetjeve të bashkisë Librazhd”** në mënyrë të drejtëpërdrejtë.

Kjo kontratë rregullon modalitetet e pranimin, trajtimit dhe përpunimit të mbetjeve, tarifën e përpunimit për ton e cila është përcaktuar nga Asambleja e Përgjithshme në vendim dhe të gjitha të drejtat dhe detyrimet e paleve në lidhje me këtë proces.

Për sa mësipër, bazuar në ligjin 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore” nenet 22 e 54 të tij, ju propozojmë miratimin e draft-kontratës bashkangjitur këtij relacioni.

Duke besuar në mirëkuptimin tuaj!